

E DREJTA NË PROCES TË DREJTË GJYQËSOR

ПРАВО НА ПРАВИЧНО СУДЕЊЕ

THE RIGHT TO A FAIR TRIAL

Abstract

The right to a fair and public trial in criminal and civil proceedings is one of the guarantees in relation to legal proceedings. Fair trial and fair hearing rights include that all persons are equal before courts and tribunals the right to a fair and public hearing before a competent, independent and impartial court or tribunal established by law. The other guarantees are the presumption of innocence, and minimum guarantees in criminal proceedings, such as the right to counsel and not to be compelled to self-incriminate. The paper examines and analyzes the rights containing the right to a fair trial in the Republic of North Macedonia. In addition, the paper treats legal institutions of the right to a fair trial, from the perspective of the European Convention on Human Rights.

***Keywords:** Judiciary, Proceedings, Human Rights, Trial, European Convention on Human Rights, North Macedonia*

1. Hyrje

E drejta për një proces të drejtë dhe të rregullt është një ndër të drejtat më substanciale që parashikohen në dokumentet ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Në nenin 6 të KEDNJ, përcaktohet e drejta

¹ Profesor në Universitetin e Tetovës - Fakulteti Juridik, Maqedoni, Tetovë. Email: ali.musliu@unite.edu.mk

themelore e individit në një proces të drejtë dhe të rregullt, ku potencohet: “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”²

E drejta për proces të drejtë, përmban në vetvete një sërë garancish që zbatohet në çdo rast veç e veç, varësisht të llojit të procesit juridik dhe rregullativës që zbatohet në rastin në konkret. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke sqaruar të drejtën në proces të rregullt, thekson se zbatohet në rastet e një procesi penal ose civil dhe me kusht që të diskutohet një të drejtë ose detyrim. Gjykata, në interpretimin e të drejtës për një “proces të rregullt”, ka mbajtur qëndrimin që: “E drejta për një proces të rregullt e parashikuar me nenin 6 dhe Protokollin 7 të KEDNJ, është një e drejtë shumë e gjerë, ku, në çdo rast duhet të shqyrtohet me kujdes nga gjykatat kompetente, duke analizuar në detaje të gjitha faktet që, në një formë ose në një tjetër, do ta cenonin të drejtat materiale apo procedurale të akuzuarit”.³

E drejta për proces të drejtë, gjen zbatimin nga momenti i fillimit dhe deri në ekzekutimin e vendimit të saj. Kjo e drejtë zbatohet në pretendimet ose mosmarrëveshjet lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile si dhe ato penale. Kjo e drejtë gjen zbatueshmërinë si në proceset civile, po edhe ato penale. Kjo e drejtë në kuadër të procesit penal, përbëhet nga disa garanca për individët e përfshihen nën hetim, gjykim apo përgjatë gjithë procedurës penale. Respektivisht, kjo e drejtë përfshinë të gjithë procesin hetues dhe gjyqësor, në kuadër të kodit penal material, dhe atij procedural. Akuza sipas kuptimit të nenit 6 të Konventës, është akti me anë të cilit njoftohet zyrtarisht personi për akuzën e kryerjes së veprës penale. Më poshtë do të elaborojmë disa nga të drejtat që derivojnë nga e drejta në proces të drejtë dhe të rregullt gjatë procedurës penale.

² Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së.

³ Nowicki, M. A. (2003). *Rreth Konventës Evropiane: Komentar i shkurtër mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, f. 265.

2. E drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme

E drejta për t'u dëgjuar dhe drejtuat nga një gjykatë e pavarur dhe paanshme, paraqitet një nga të drejtat themelore që derivojnë nga e drejta për proces të drejtë dhe të rregullt. Gjykata e pavarur dhe e paanshme qëndron mbi palët gjatë procedurës penale, ju jep mundësi të barabarta palëve në proces për të shtëlluar pretendimet e tyre dhe për të paraqitur prova mbi të cilat ato mbështesin pretendimet. Mundësia për tu drejtuar gjykatës, në bazë të nenit 6 të KEDNJ dhe Protokollit nr. 7, parasheh garantimin e saj de facto, jo vetëm de jure. Në asnjë rast, një gjykatë nuk mund të refuzojë shqyrtimin e një çështje me arsyetimin që nuk ekzistojnë normat juridike që rregullojnë çështjen në fjalë. Gjykata ka gjithmonë juridiksion për shqyrtimin e pretendimeve të palëve në procedurën penale. Neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut përcakton që çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, në procedurë të mbështetur mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës. Njëkohësisht, e drejta për proces të rregullt nënkupton edhe të drejtën e apelit të një vendimi në procedurën penale. Protokollit 7 i KEDNJ-së përcakton: “Çdo person i deklaruar fajtor për një veprë penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, janë të përcaktuara me ligj”.⁴ Pra, vendimi i gjykatës nuk mund të ndryshohet nga një organ jo gjyqësor, me përjashtim të rasteve të amnitive ose të faljeve të njohura si institute juridike nga kushtetuta dhe të dhëna nga legjislativi ose kryetari i shtetit. Pavarësia e gjyqësorit është parë në përgjithësi si gurthemel i rregullave të drejtësisë. Pavarësia gjyqësore mund të garantohet vetëm nëse korniza, në të cilën gjykatësit ushtrojnë funksionet e tyre, jep garanci të mjaftueshme kundër përpjekjeve që në mënyrë të rregullt të ndikojë në administrimin e drejtësisë. Përsëri, dallimet midis juridiksioneve kombëtare dhe sistemeve ligjore e bëjnë të pamundur për të ndërtuar një formulë universale për kërkesat të cilat duhet të plotësohen që një gjyqësor të pavarur të ekzistojë.

⁴ Neni 2, paragrafi 1 i Protokollit 7 të KEDNJ-së.

Megjithatë, ka disa faktorë që përcaktojnë nëse korniza ligjore në një vend të caktuar siguron kushte për një gjyqësor të pavarur. Pavarësia e gjyqtarit është një nga elementet e domosdoshme për një pushtet gjyqësor të pavarur. Gjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) në Campbell dhe Fell v Mbretërisë së Bashkuar dhe Incal v Turqi, ku Gjykata themeloi kërkesat e "pavarësisë", në të cilat përfshihen: mënyra e emërimit të gjykatësve, kohëzgjatja e mandatit të tyre, garancionet kundër presionit të jashtëm dhe pyetjet, nëse organi paraqet një pamje të pavarësisë.⁵ Pavarësia e gjykatësve duhet të garantohet si pasojë e dispozitave të Konventës dhe të parimeve kushtetuese, për shembull, duke futur dispozita të veçanta në kushtetutat ose në legjislacionin tjetër ose duke inkorporuar dispozitat e këtij rekomandimi në ligjet e vendit. Si çështje të traditës ligjore të secilit shtet, rregulla të tilla mundësojnë. Vendimet e gjykatësve nuk duhet të jenë çështje e çfarëdolloj shqyrtimi jashtë ndonjë procedure të apelit siç është e mundësuar sipas ligjit, si dhe kushtet e zyrës së gjykatësve si dhe shpërblimi i tyre duhet të garantohet me ligj. Asnjë organ, përveç gjykatave, nuk ka të drejtë të vendosë mbi kompetencat e tij, siç janë të definuar me ligj, me përjashtim të vendimit për amnisti, falje ose ngjashëm me këtë, qeveria ose administrata nuk duhet të kenë të drejtën të ndërmarrin asnjë vendim që shfuqizon në mënyrë retroaktive vendimet gjyqësore. Pushteti ekzekutiv dhe legjislativ duke të sigurojë që gjykatësit janë të pavarur dhe se nuk ndërmerren hapa të cilat mund të rrezikojnë pavarësinë e gjykatësve.⁶

3. Presumimi i pafajësisë

Parimi i presumimit të pafajësisë, është një nga shtyllat kyçe të tërësisë së të drejtës për procedurë të drejtë dhe të rregullt, ku parashihet se: "Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht".⁷ Çdo i akuzuar ka të drejtë të presumohet i pafajshëm për kryerjen ose jo të ndonjë vepre penale, derisa fajësia e tij/saj nuk është e vërtetuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor. Kjo e drejtë përcakton edhe detyrimin e autoriteteve hetuese dhe atyre ekzekutive, të mos bëjnë deklarata publike për fajësinë e një

⁵ Pavarësia e gjyqësisë. Analiza juridike. Raport i Misionit të OSBE-së në Maqedoni për vitin 2013, f. 12-14.

⁶ Ibidem, f. 136.

⁷ Neni 6, paragrafi 2 i KEDNJ-së.

personi të dyshuar deri në çastin e dhënies së një aktgjykimi përfundimtar nga organet kompetence gjyqësore. Pra, proceset e gjykimit nuk mund të përdoren sensacion publik, për të nënkuptuar fajin e një individi që është i ende në proces të hetuesisë. Gjithashtu, kjo e drejtë nënkupton edhe të obligim e palës akuzuese për të mbledhur prova dhe për të dëshmuar akuzën. Ky detyrim është karakteristike për sistemet akuzatore të procedurës penale, si dhe të drejtën e pandehurit për të heshtur. Barra e provës i ngelet akuzës, për shkak se organi i akuzës ka mundësi të përdorë të gjithë forcën dhe mjetet në dispozicion të organeve hetuese, duke analizuar dhe nxjerrë në përfundime lidhur me akuzën që ngrenë ndaj individit. Sikur barra e provës do t'i kalonte individit, i njëjti do të vendoseshe në pozitë inferiore ndaj organit hetues. Por kjo nuk do të thotë se i pandehuri, përgjatë procedurës penale është në pozitë inferiore ndaj organit hetues, por obligimin e dëshmisë i ngelet organit hetues.⁸ Neni 13 i Kushtetutës së RMV-së garanton që “personi i akuzuar për vepër penale, do të konsiderohet i pafajshëm deri sa fajësia e tij nuk do të vërtetohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor”.⁹

Pakti Ndërkombëtarë për të Drejta Civil dhe politike, në nenin e saj 14 parasheh barazi dhe transparencë të plotë gjatë procedurës penale. Pakti më tutje shton se: “Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile. Shtypi dhe publiku mund të largohen gjatë gjithë procesit ose të një pjese të tij, qoftë kur e kërkon interesi i sjelljes së moralshme, i rendit publik ose i sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur e kërkon interesi i jetës private të palëve, qoftë edhe kur gjykata e quan krejtësisht të domosdoshme në qoftë se, për disa rrethana të veçanta të çështjes, publiciteti mund të dëmtonte interesat e drejtësisë. Megjithatë çdo gjykim i dhënë në çështjen penale ose civile do të jetë publik, me përjashtim të rasteve kur interesi i të miturve kërkon ndryshe ose në

⁸ Me rëndësi është të përmendet edhe parimi in dubio pro reo, se çdo dyshim vlerësohet në favor të pandehurit. Për më tepër shih në: Sijerčić-Čolić, H. (2008). *Krivično procesno pravo*. Pravni fakultet, Univerzitet u Sarajevu, f. 140-143.

⁹ Kushtetuta e RMV-së, neni 13, paragrafi 1.

qoftë se procesi ka të bëjë me mosmarrëveshje martesore ose me kujdestarinë e fëmijëve”.¹⁰

Ndër problematikat kryesore që cenon të drejtën e presumimit të pafajësisë, paraqiten paragjykimet publike dhe mediatike. Rastet kur media nxiton të deklaroj fajtorë apo të nxjerrë përfundime lidhur me fajësinë e një individi ose grupi, duke përdorur deklaratatë të hapura dhe etiketuese, paraqet një dhunim të hapur të të drejtës për proces të rregullt, pasi një veprim i tillë mediatik krijon paragjykime të gabuara të publiku dhe gjykata. Shpesh herë ndodhë që mediat të nxjerrin përfundime të parakohshme në lidhje me fajësinë e një personi nën hetim apo gjykim, përbën edhe një lloj presioni keqberës ndaj gjykatës, e cila mund të ndikohet negativisht ndaj procesit gjyqësor. Sot rastet e tilla janë të shumta, sidomos në luftën kundër terrorizmit, ku në disa raste kemi deklarata bombastike për “terrorizëm islamik”, ndaj individit ose grupi, ku në disa raste del pafajësia e personave të inkriminuar nga ana e organeve të rendit, ose mediat.¹¹ Duke marrë parasysh këtë të drejtë, Gjykata Evropiane për Të Drejtat e Njeriut ka theksuar që edhe transmetimi televiziv i seancave gjyqësore, mund të bëhen shkasë për një keqkuptim nga ana e publikut ndaj sistemit të drejtësisë.

4. E drejta e mbrojtjes në heshtje (Mosdeklarimi i të pandehurit)

E drejta e mbrojtjes në heshtje është e drejtë ligjore e çdo personi. Kjo e drejtë është e njohur, në mënyrë eksplicite ose me Konventë, në shumë prej sistemeve ligjore të botës. E drejta mbulon një numër çështjesh të përqendruar rreth të drejtës së të akuzuarit ose të pandehurit

¹⁰ PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966 HYRË NË FUQI: 23 mars 1976, në përputhje me nenin 49.

¹¹ Shembull eklatant në Maqedoni kemi rastin e ashtuquajtur “Monstra”. Në vitin 2012 pesë persona nga Shkupi, duke peshkuar u vranë në mënyrë misterioze. Të vrarë kanë qenë katër djelmosha të rinj prej 18 deri më 21, si dhe një 45 vjeçar peshkatarë. Më **1 maj** të vitit 2012 në një aksion policor arrestohen më shumë se 20 të dyshuar nën emrin e koduar “Monstra, ku mediat i cilësuan si “terrorist islamik”. Për vrasjen e pesëfishtë tek liqeni i Smillkovës, më 12 prill të viti 2012, u dënuan me burg të përjetshëm gjashtë persona, ndërsa një u lirua nga akuza. Gjykata Supreme e RM, më 24 nëntor 2017 kthen rastin për rigjykim, dhe liron nga paraburgimi të të akuzuarit. Deri më tani ky rast nuk ka marrë një epilog të plotë gjyqësor, por shërben si rast i gjykimin publik para epilogut gjyqësor.

për të refuzuar të komentojë ose të japë përgjigje kur pyetet, ose para ose gjatë procedurave ligjore në gjykatën ligjore. Kjo mund të jetë e drejta për të shmangur vetë-inkriminimin ose e drejta që të qëndrojnë i heshtur gjatë marrjes në pyetje. E drejta zakonisht përfshinë dispozitën se komente negative apo konkluzione nuk mund të bëhen nga gjyqtari ose juria në lidhje me refuzimin e të pandehurit për t'iu përgjigjur pyetjeve para ose gjatë një seancë gjyqësore, në seancë shqyrtimi ose ndonjë procedurë tjetër juridike. Kjo e drejtë përbën vetëm një pjesë të vogël të të drejtave të të pandehurit si një tërësi.

As arsyet a as historia pas të drejtës së mbrojtjes në heshtje nuk janë krejtësisht të qarta. Maxima latine *nemo tenetur se ipsum accusare* (askush nuk është i detyruar të akuzojë veten) u bë një thirrje për të mbledhur disidentët fetarë dhe politik të cilët ndiqeshin penalisht në Star Chamber (gjykatë Angleze) dhe Komisioni i Lartë i Anglisë i shekullit XVI. Njerëzit që vinin para këtyre gjykatave ishin të detyruar të bëjnë betimin ex officio (sipas detyrës zyrtare) me të cilën ata betoheshin se pyetjeve të parashtruara do t'iu përgjigjen me të vërtetën pa mos e ditur për çka ishin të akuzuar. Kjo krijoi atë që është quajtur trilema mizore ku këta të akuzuar kanë qenë të detyruar të zgjedhin në mes: kryerjes së mëkatit mortal (të vdekshëm) të dëshmisë së rrejshme (nëse ata kanë gënjyer nën betim për të mbrojtur veten e tyre); dënim të ashpër për mospërfillje të gjykatës (nëse refuzonin të përgjigjen); ose tradhti e detyrës së tyre “natyrore” të vetë mbrojtjes (nëse e thonin të vërtetën për të mbajtur (nderuar) betimin e tyre).

Pas revolucioneve të shekullit XVII, sipas disa llogarive historike, e drejta e mbrojtjes me heshtje u krijua në ligj si një reagim i njerëzve me ekseset e inkuizicionit mbretërorë në këto gjykata. Refuzimi i procedurave të gjykatave të Star Chamber dhe Komisionit të Lartë më në fund rezultoi me ngritjen e parimit, sipas juristit të Shteteve të Bashkuara dhe ekspertit për ligjin e provave John Henry Wigmore, “se asnjëri nuk është i detyruar të inkriminojë veten, në asnjë akuzë (pa marrë parasysh se sa në mënyrë të duhur është krijuar kjo), ose në ndonjë gjykatë (jo vetëm në gjykatat kishtare apo gjykatat e Star Chamber)”. Ajo u zgjerua gjatë restaurimit Anglez (nga 1660 e tutje) që të përfshijë “një dëshmitarë të zakonshëm, dhe jo vetëm palën e akuzuar”.¹²

¹² Më tepër lidhur me të drejtën e mbrojtjes në heshtje në procedurën penale shih në: Муслиу, Х. (2018). Право на молчење во казнената постапка. Докторска дисертација, УКИМ-Правен Факултет, Јустиниан Први. Скопје, f. 254-257.

Megjithatë, një periudhë më pas e drejta për të heshtur nuk ishte gjithmonë një realitet praktik për të gjithë të akuzuarit në gjykatat Angleze. Me qasje të kufizuar të këshilltarëve ligjorë (shpesh në varësi të statusit shoqërorë të të akuzuarit), një standard kalimi i provës, dhe një sistem në përgjithësi mosbesues i heshtjes së të pandehurve, një kriminel i akuzuar i cili qëndronte i heshtur ishte shpesh kryerje e vetë-vrasjes figurative apo literale. Megjithatë, ajo mbeti një e drejtë themelore në dispozicion të të pandehurit dhe ka qenë një praktikë e pranuar gjatë shekujve të fundit. Në Angli, praktika e pyetjes gjyqësore të personave të pandehur në gjykim (si dallim nga pyetjet para gjyqit), në të vërtetë nuk u zhduk deri në shekulli XVIII. Por, nga shekulli i XIX, të pandehurit nuk i lejohej të japë dëshmi nën betim edhe nëse ai dëshiron një gjë të tillë - gjithashtu është thënë se është një reagim ndaj pabarazive të Star Chamber dhe Komisionit të Lartë.¹³

Heshtja si abstenim për të thënë diçka, ka kuptime të ndryshme, në jetën e përditshme dëgjohet shpesh shprehja: “heshtja është pohim” me të cilën i atribuohet përgjegjësi – në aktet e përditshme të jetesës - atyre që preferojnë të qëndrojnë të heshtur.¹⁴ Në drejtësi, heshtja nuk është asgjë. Nuk ka asnjë vlerë, përveç se kur ligji ose marrëveshja midis palëve i japin ndonjë kuptim. Kështu, për shembull, kundër një vendimi gjyqësorë, në qoftë se pala e interesuar nuk paraqet ndonjë ankesë kontestimi, ligji presumon që pala e interesuar është e kënaqur dhe për këtë arsye i pranon efektet që rrjedhin prej saj.

Në të drejtën penale, në veçanti, heshtja nuk nënkupton që i pandehuri i pranon faktet dhe më pak që të marrë përgjegjësi për to; dhe për këtë masë është një mundësi e zgjedhjes së të pandehurit. Përballë një akuze, sipas detyrës zyrtare ose të palës, i pandehuri mund të zgjedh: të ofroj versionin e vet mbi faktet me të cilat akuzohet ose të hesht, dhe nga kjo të mos rrjedh asnjë pasojë negative për interesat e tij. Megjithatë, cilado qoftë zgjidhje – qoftë deklarimi, qoftë mbrojtja në heshtje – është gjithmonë fakultative, dhe në këtë kuptim, është parimi i të

¹³ Azad, Mak (3 October 2007). "Do citizens get the protection provided by the constitution?". The Daily Star. Retrieved 2 October 2011, Të dhëna nga interneti: <http://www.thedailystar.net/law/2007/10/03/index.htm>. Zbritur me 23.09.2011; Bram v. United States, 168 U.S. 532 (1897), U.S. Supreme Court, Të dhëna nga interneti: <http://supreme.vlex.com/vid/bram-v-united-states-20060675>.

¹⁴ Texto del artículo «El silencio del imputado», por ©Laurence Chunga Hidalgo, Juez Especializado del Juzgado Penal Unipersonal de Chulucanas, publicado en el diario El Tiempo el 18 de diciembre de 2009. El derecho de permanecer callado. Të dhëna nga interneti: <http://blog.pucp.edu.pe/item/85480/el-derecho-a-permanecer-callado>.

drejtës në mbrojtje që i ndihmon. Për këtë arsye, kërkohet që i pandehuri të njoftohet dhe të dijë se çka është në të vërtetë “mbrojtja në heshtje” dhe cilat janë pasojat e saj. Pra, “mbrojtja në heshtje” duhet të jetë rezultat i një zgjedhje të lirë dhe të informuar.

E drejta e mbrojtjes në heshtje është një produkt i parimit të presumimit të pafajësisë dhe motivon nevojën që ai që akuzon duhet të paraqes prova që vërteton kërkesën e tij. Ky është prokurori publik i cili si ushtrues i veprimeve penale, ka për detyrë që ta mbështes akuzën e tij dhe nëpërmjet provave të besueshme, të dobësoj heshtjen e të pandehurit ose vetë versionin e tij që ka dhënë mbi faktet përkatëse.¹⁵

Pavarësisht nga deklaratat dhe qëllimi që përfshinë e drejta e mbrojtjes në heshtje, komuniteti bën që anëtarët e saj të mendojnë se kanë “detyrë që të thonë diçka” dhe se “nuk mund të qëndrojnë të heshtur” para një akuze. Do të përshkruajmë gjendjen e punës së gazetarëve, ata gazetarë që punojnë në teren në stacionet e policisë ose “skenat e krimin” të cilët, në kohën që e shohin “të akuzuarin” (ndërsa ky është i prangosur dhe tërhiqet zvarrë), e pyesin: “Jeni akuzuar për këtë, këtë gjë, çfarë keni për të thënë për këtë” dhe fraza të ngjashme që pasojnë mund të shihen në televizion, me të cilën theksohet inkurajim hetues në vetëdijen e opinionit publik dhe që detyron teleshikuesit në një përgjigje pothuajse automatike: “nëse qëndron i heshtur domethënë që ka diçka”.

Në vlerësimin e fakteve, të drejtat e njeriut janë përtej kujdesit policorë dhe gazetarëve si dhe etjes së komunitetit që të dinë detajet e deklaratave, shprehje, gjeste që mund të ofroj i pandehuri apo personat e lidhur me të. Në cilëndo qoftë rrethanë, zakonisht marrim si të vetme dhe të vlefshme shprehjet e zgjedhura nga mediat, kur në fakt këto deklaratat nuk do të kenë asnjë vlerë ligjore nëse më parë të pandehurit nuk i është garantuar e drejta e mbrojtjes dhe e drejta e jo-inkriminimit (kundër vetë inkriminimit), që gjithashtu janë të drejta që i takojnë. Nga një informacion i padëshirueshëm dhe keqkuptimit të një pjese të së drejtës, rrjedh një ndjenjë kolektive e frustruar sa i përket drejtësisë, që ka pak të bëjë me shprehjen e Ulpian-it: “Vullneti konstant dhe i vazhdueshëm për t’i dhënë çdonjërit atë që korrespondon”.¹⁶

A përfshinë në vete e drejta për të heshtur edhe të drejtën për të gënjer?:- Personi mbi të cilën bie akuza – mundësia e mosfajësimin të vetes (kundër vetë-inkriminimit) – mund të zgjedh për mbrojtje në

¹⁵ Муслиу, Х. (2018). Право на молчење во казнената постапка. Докторска дисертација, УКИМ-Правен Факултет, Јустиниан Први. Скопје, f. 255

¹⁶ Ibidem, f. 256.

procedurë penale mënyrën që e konsideron më të përshtatshme për interesat e tij, dhe në asnjë rast nuk mund të detyrohet, nën shtypje ose kërcënim, të deklarojë kundër vetes ose të pohoj fajësinë.¹⁷

Pra, garancia kundër vetë-inkriminimit i jep të pandehurit mundësi të ndryshme. Së pari të drejtën e mbrojtjes në heshtje, pra, i pandehuri është i lirë që të deklarojë ose të mos deklarojë në procedurë penale. Së dyti, dhe në rast se deklaroi, ka të drejtën që të vendos lirisht përmbajtjen e deklaratës së tij. E drejta e mosdeklarimit kundër vetes përmban respektimin e vullnetit të të pandehurit që të heshtë.

Problemi qëndron në atë se në qoftë se i pandehuri vendos që të deklarojë a mund të kufizohet vetëm shprehimisht të shfajësojë veten apo të jap edhe versionin e vet të asaj që ndodhi. Kjo e fundit ngre debat rreth asaj që e drejta e mosdeklarimit kundër vetes (shfajësimit) a përfshinë edhe mundësinë për të gënjyer. Asnjë rregull - as shtetërore e as ndërkombëtare nuk shpall zyrtarisht ekzistimin e një të drejtë për të gënjyer në procedurë penale. Mirëpo Ligji për procedurë penale i ka dhënë të pandehurit të drejtën që të deklarojë rrejshëm (të shfajësojë veten) pra të drejtën që të gënjejë, përveç në rast se me deklarimin e tij të rrejshëm, pa të drejtë, fajin ia ngarkon dikujt tjetër.

Siç duket në ditët e sodit në mënyrë universale është pranuar parimi i privilegjit të të pandehurit kundër vetë-inkriminimit. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është e garantuar me Kushtetutë.¹⁸ Në Maqedoni nuk është shprehur qartë në Kushtetutë, por mund të nxirret nga parimet e garantuara me Kushtetutë të dinjitetit të njeriut dhe e drejta e zhvillimit të lirë të personalitetit. Si rezultat i privilegjit, Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë parasheh që i pandehuri gjatë marrjes në pyetje ka të drejtë “t’i përgjigjet akuzës si dhe të drejtën e mbrojtjes në heshtje”¹⁹. Pra, në Republikën e Maqedonisë privilegji kundër vetë-inkriminimit është paraparë me Kushtetutë si dhe me Ligjin për procedurë penale.

Parimi i privilegjit kundër vetë-inkriminimit nuk është përmendur në mënyrë specifike në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përmban që e drejta e mbrojtjes në heshtje gjatë marrjes në pyetje të policisë dhe privilegji kundër vetë-inkriminimit janë të njohura në përgjithësi nga standardet

¹⁷ Ibidem, f. 257.

¹⁸ Amendamenti nr. 5 i Kushtetutës së SHBA-së garanton të drejtën e mbrojtjes në heshtje.

¹⁹ Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 150, 18. 11. 2010, neni 206 parag. 2;

ndërkombëtare që qëndrojnë në zemër të nocionit të një procedure të drejtë, pra e ka bazuar në parimin e gjykimit të drejtë dhe publik të të pandehurit si dhe në parimin e presumimit të pafajësisë.²⁰

Ndër shumë aktgjykime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të cilat është vërtetuar shkelja e parimit të gjykimit të drejtë gjatë marrjes ose përdorimit të deklaramit të të pandehurit do të veçojmë atë që lidhet kryesisht me veprimet që shkelin privilegjin kundër vetë-inkriminimit ose shkeljen e presumimit të pafajësisë në lidhje me shkeljen e rregullave të saj mbi barrën e provës dhe ndarjen e rrezikut të mos provimit të fajit të të pandehurit.

5. Ndalimi i dënimit të pa parashikuar në ligj (Nullum crimen, nulla poena sine lege)

Parimi zullum crimen, nulla poena sine lege, konfirmon ndalimin e fuqisë prapavepruese të ligjit dhe ndalimi i dënimit i cili nuk është e parashikuar me ligj si vepër penale. Neni 7 i KEDNJ-së, parasheh se: “Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.”²¹ Neni 14 i Kushtetutës së RMV-së garanton që “askush nuk mund të dënohet për vepër e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar me ligj ose me normë tjetër si vepër penale, dhe për të cilën nuk ka qenë i parashikuar dënim”.²²

Ky parim siguron të drejtën që askush tymos mund të dënohet me një dënim dhe për një veprim që nuk parashikohet nga ligji, si dhe askush nuk mund të dënohet me një dënim më të rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në çastin kur vepra ka qenë e kryer. Ky parim ka një rëndësi të jashtëzakonshme në garantimin e një procesi të drejtë dhe të rregullt gjyqësor.

Në drejtësi parimisht norma nuk ka fuqi retroaktive (prapavepruese). Mirëpo kjo e drejtë ka edhe përjashtime në procedurën penale, në rast kur ligji i ri favorizon pozitën e të pandehurit. Rastet kur ligji i

²⁰ Murray v. UK [1996] ECHR 3at para. 45, (1996) 22 EHRR 29, 22 EHRR 29 (8 February 1996), European Court of Human Rights; Murray v. UK, (1996) 22 EHRR 29, at paragraph 45 (ECtHR 1973), Të dhëna nga interneti: <http://www.bailii.org/eu/cases/ECHR/1996/3.html#para45>.

²¹ Neni 7, paragrafi 1 KEDNJ-së.

²² Kushtetuta e RMV-së, neni 14, paragrafi 1.

ri favorizon pozitën e të pandehurit, nuk mund të jetë në kundërshtim me KEDNJ dhe vetë qëllimi i saj, sepse në këtë rast, fuqia prapavepruese nuk e rëndon por e favorizon pozitën e të pandehurit. Edhe pse KEDNJ nuk e parasheh shprehimisht parimin e fuqisë retroaktive të normës juridike në favor të të pandehurit, kjo e drejtë parashihet me Paktin Ndërkombëtarë për të drejta Civile dhe Politike. Neni 15 i PNDCP parasheh se: “Askush nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk kanë qenë vepra penale sipas të drejtës kombëtare ose ndërkombëtare në kohën kur janë kryer. Po ashtu nuk duhet të jepet një dënim më i rëndë se ai që mund të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale. Në qoftë se më vonë, pas kryerjes së veprës, ligji parashikon një dënim më të lehtë, keqbërësi duhet të përfitojë nga kjo”.²³

6. E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë (Ne bis in idem)

Ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale, që njihet si parimi ne bis in idem, parasheh një nga të drejtat themelore në procedurën penale. Konventa Evropiane në mënyre eksplicite në Protokollin e saj të 7 përcakton se: “Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga gjykatat e të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai është deklaruar më parë i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të këtij Shteti”.²⁴ Poashtu neni 14, paragrafi 2 i Kushtetutës së RMV-së përcakton se “askush nuk mund të gjykohet sërish për vepër për të cilën ka qenë i dënuar një herë, dhe për të cilën është marrë vendim i plotfuqishëm gjyqësor”.²⁵

Duhet sqaruar, se kjo ndalesë nuk parasheh dhe ndalesën absolute në rast të rihapjes së procedurës të paraparë me ligjin për procedurë penale. Prandaj, dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit në fjalë, në rast se fakte të reja ose të zbuluar rishtas, ose një ves

²³ PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966 HYRË NË FUQI: 23 mars 1976, në përputhje me nenin 49.

²⁴ Neni 4, paragrafi 1 i Protokollit 7 të KEDNJ-së.

²⁵ Kushtatuta e RMV-së, neni 14, paragrafi 2. chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://www.sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf

themelor në procedurën e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.²⁶

Në kuadër të parimit *ne bis in idem*, vlen të potencojmë të drejtën në zhdëmtim në rast të gabimit gjyqësor. Protokollit 7 i Konventës potencon se: “Kur një dënim penal përfundimtar është anuluar më vonë, ose në rast faljeje, për shkak të një fakti të ri ose të zbuluar rishtas që provon kryerjen e një gabimi gjyqësor, personi që ka pësuar dëmin për arsye të këtij dënimi zhdëmtohet, sipas ligjit ose zakonisht në fuqi në Shtetin në fjalë, me përjashtim të rastit kur është provuar se moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.”²⁷

Conclusion

We can conclude that the right to a fair trial is a fundamental human right, because, without respecting this right, rule of law and democratic system collapse. The right to a fair trial is a sublime right, equires that all parties to a proceeding must have a reasonable opportunity of presenting their case under conditions that do not disadvantage them as against other parties to the proceedings. The right to a fair trial has special importance in international human rights law. The Republic of Northern Macedonia is a signatory to all basic acts that protect right to a fair trial and in the focus of the legal framework is fully harmonized with international human rights norms.

Recensentë:

Prof. dr. Nazmi Maliqi

Prof. dr. Afrim Osmani

Literatura

- Nowicki, M. A. (2003). *Rreth Konventës Evropiane: Komentar i shkurtër mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, fq. 265.

- Pavarësia e gjyqësisë. Analiza juridike. Raport i Misionit të OSBE-së në Maqedoni për vitin 2013, fq. 12-14.

- Sijerčić-Čolić, H. (2008). *Krivično procesno pravo*. Pravni fakultet, Univerzitet u Sarajevu, fq. 140-143.

²⁶ Neni 4, paragrafi 2 i Protokollit 7 të KEDNJ-së.

²⁷ Neni 3 i Protokollit 7 të KEDNJ-së.

- PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966 HYRË NË FUQI: 23 mars 1976, në përputhje me nenin 49.

- Konventa Evropiane për të Drejta dhe Liritë Themelore të Njeriut e miratuar në Romë më 04.10.1950, si dhe plotësuar me Protokollet bazë: shoqëruar nga Protokollet Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13 dhe ndryshuar me Protokollet Nr. 11 dhe 14.

- Komiteti Evropian i të Drejtave të Njeriut, Koment i Përgjithshëm Nr. 6, UN Doc.HRI/GEN/1/Rev.6, (2003) paragrafi 6

- Муслиу, X. (2018). Право на молчење во казнената постапка. Докторска дисертација, УКИМ-Правен Факултет, Јустиниан Први. Скопје, fq. 254-257.

- Azad, Mak (3 October 2007). "Do citizens get the protection provided by the constitution?". The Daily Star. Retrieved 2 October 2011, Të dhëna nga interneti: <http://www.thedailystar.net/law/2007/10/03/index.htm>. Zbritur me 23.09.2011; Bram v. United States, 168 U.S. 532 (1897), U.S. Supreme Court, Të dhëna nga interneti: <http://supreme.vlex.com/vid/bram-v-united-states-20060675>.

- Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 150, 18. 11. 2010, neni 206 parag. 2;

- Murray v. UK [1996] ECHR 3at para. 45, (1996) 22 EHRR 29, 22 EHRR 29 (8 February 1996), European Court of Human Rights; Murray v. UK, (1996) 22 EHRR 29, at paragraph 45 (ECtHR 1973), Të dhëna nga interneti:

<http://www.bailii.org/eu/cases/ECHR/1996/3.html#para45>.

- PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966 HYRË NË FUQI: 23 mars 1976, në përputhje me nenin 49.